

P. Pusha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT SHKODER

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 68/5 Prot.

Data 26.02.2021

DREJTORIA

Lazër Çardaku

2. doli
1. Mars 2021

Nr. 231 Prot.

Shkodër, me 24.02.2021

L E N D A: Dërgojmë Analizën "Mbi punën e Prokurorisë së Apelit Shkodër për vitin 2020".

ZYRËS SË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë Analizën vjetore "Mbi punën e Prokurorisë së Apelit Shkodër për vitin 2020".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Lazer ÇARDAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT SHKODËR



ANALIZA VJETORE E VITIT 2020

Shkurt 2021

HYRJE

Prokuroria e Apelit Shkodër, parashtron në këtë raport-analizë, funksionimin e saj sipas Kushtetutës dhe ligjeve, në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si dhe funksione të tjera të ngarkuara me ligje të posaçme.

Prokuroria e Apelit Shkodër, e shtrin funksionin e saj në qarkun e Shkodrës, në qarkun e Lezhës dhe në qarkun e Kukësit. Sipas organizimit administrativ të këtyre qarqeve, në të përfshihen Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë .

Duke qënë tre qarqe të mëdha, puna e përballuar në vitin 2020 nga kjo Prokurori, me numër të kufizuar prokurorësh, ka qënë voluminoze.

Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave ka qënë prioritet në ushtrimin e funksioneve, edhe përgjatë vitit 2020. Rol të posaçëm në këtë drejtim ka patur përfaqësimi sa më dinjitoz i prokurorit në çështjet e ankimuar nga prokurorët.

Në vitin 2020, ka pasur ulje të veprave penale kundër korrupsionit, fakt i cili bashkëshoqërohet edhe me një ulje të numrit të çështjeve të ankimuar dhe të përfaqësuar në gjykimin në Gjykatën e Apelit me të pandehur të akuzuar e dërguar në gjykim për këtë aktivitet kriminal.

Në lidhje me veprat penale, që lidhen me faktet e kundraligjshme që si objekt material kanë lëndët narkotike të cilat kanë pësuar një ulje të lehtë, në dërgimin dhe përfaqësimin e tyre në gjykim. Referuar gjykimeve në Gjykatën e Apelit Shkodër, mbetet problem evidentimi në një shkallë më të gjerë jo vetëm përdoruesit e lëndës narkotike por në një shkallë më të gjerë të personave që janë të angazhuar me organizimin, shpërndarjen e farës, me prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Problematik vazhdojnë të mbeten konfliktet e pronësisë, që çojnë në kryerjen e veprave penale të fallsifikimit apo të shpërdorimit të detyrës nga funksionarët përkatës.

Vjedhjet vazhdojnë të kenë një peshë relativisht të madhe në raportin e përgjithshëm të veprave penale të ndodhura në këto qarqe.

Lufta kundër këtyre veprave penale, nuk mund të zhvillohet e vetme, pasi ndikojnë kryesisht faktorët socialë, në rastin e vjedhjes së pasurisë.

Megjithatë angazhimi nga ana jonë ka qënë maksimal për të përfunduar gjykimin në Gjykatën e Apelit një kohë sa më të shkurtër, duke dënuar me vendim të formës së prerë personat përgjegjës.

Në ushtrimin e funksioneve, kemi mbajtur parasysh respektimin e të drejtave të njeriut, qoftë të viktimave, familjarëve të tyre ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve, të paraburgosurve apo të dënuarve. Ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, sollën për viktimat e veprave penale, të drejta për një pjesmarrje më të madhe në procedim, gjë e cila është reflektuar në punën e kryer.

Përparësi e veçantë i është dhënë të miturve në konflikt me ligjin, qoftë të dëmtuar apo viktima, duke pasur parasysh edhe pjesëmarrjës në gjykim, për veprat penale të kryera nga të miturit në konflikt me ligjin dhe ndaj të miturve.

Një nga prioritetet e punës sonë ka qënë rritja e efikasitetit lidhur me ndëshkimin e veprave penale të dhunës në familje si në ashpërsimin e masave të sigurimit dhe asaj të dënimit ndaj autorëve të këtyre veprave penale për të cilat dhe Gjykata e Apelit Shkodër na ka përkrahur në të gjitha kërkesat tona dhe apelimet e bëra nga ana e prokurorëve të shkallës së parë. Ndonëse numri i çështjeve ka pësuar pak rritje krahasuar me një vit më parë (nga 39 çështje në vitin 2019 në 43 çështje për vitin 2020), ashpërsia në masat e sigurimit dhe asaj dënimit kanë pësuar rritje. Çmujmë se krahas politikës penale dhe ashpërsimit të saj, që ndiqet nga organet e drejtësisë lidhur me këtë çështje, duhet sensibilizuar akoma më shumë gjithë shoqëria, aktoret e tjerë, institucionet shoqatave si dhe ofrimi i përmirësimit të kushteve social ekonomike, i qëndrave të përkrahjes sociale etj.

Gjatë periudhës raportuese rendësi akoma më shumë i kemi kushtuar bashkëpunimit me prokurorit e rretheve në të cilën ushtron kompetencat kjo Prokurori Apeli. Ky bashkëpunim ka konsistuar në mënyrën se si paraqiten ankimet e prokurorëve, vijueshmërinë e tyre, ku një rol të veçantë në përmbushjen e funksioneve tona, e kanë Prokurorët e Prokurorive përkatëse në argumentimin e ankimeve dhe kundërshtimet në lidhje me vendimet e gjykatave. Në lidhje me institucionet e tjera si Gjykatën, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme etj, bashkëpunimi ka qënë i frytshëm, korrekt dhe institucional.

Gjatë vitit 2020, dhe për vëtë rëndësinë që kanë, rol të veçantë i është kushtuar shqyrtimit të kërkesave për ekstradim, njohje të vendimit të huaj, duke marrë të gjitha masat e duhura për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe parimin e reciprocitetit. Për të gjitha vendimet e Gjykatës, (për këto çështje në gjykim) është komunikuar me Drejtorinë e Marrdhënieve me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokuroritë e rretheve në vartësi dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar masave të marrura për ndjekjen dhe zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin konkret të këtyre udhëzimeve dhe vijimin e rregullt të detyrës.

Në përmbushjen e detyrave të saj një rol të rëndësishëm ka luajtur administrata e prokurorisë e cila me punën e saj ka bërë të mundur vënien në dispozicion të dosjeve dhe të gjithë materialeve të domosdoshëm në punën e prokurorëve, dërgimin e urdhërave dhe akteve të tjera pa asnjë vonesë pranë IEVP-ve dhe Prokurorive përkatëse, përpunimin e statistikave dhe paraqitjen dhe dërgimin në kohë në Prokurorinë e Përgjithshme etj.


I. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË SË APELIT SHKODËR

Përgjatë vitit 2020, Prokuroria e Apelit Shkodër, ka përfaqësuar akuzën në gjykimin e 730 çështjeve.

Në këtë analizë, do të evidentojmë edhe problematikën e hasur, rezultatet e arritura dhe krahasimin me vitet e mëparshme.

Volumi i punës për vitin 2020

Çështje penale Themeli	198
Masa Sigurimi	272
Administrative penale	260
Gjithsej	730



- 198 çështje themeli me 263 të pandehur.
- 33 apele janë shqyrtuar mbi ankimin e Prokurorit
- 175 apele janë shqyrtuar mbi ankimin e të pandehurve

(Shenim: Ankimet mund të jenë ushtruar edhe nga të dy palët njëkohësisht).

Këto çështjeve penale kanë pasur si bazë ankimet e bëra nga Prokurorët si dhe të pandehurit ndaj vendimeve të Gjykatave të Shkallës së Parë, nga institucionet e ndryshme DRSSH apo në çështje të ankimuar kryesisht nga prokurorët.

- **Gjate vitit 2020 janë gjykuar 272 çështje me masa sigurimi personal, me 387 të pandehur.**
- 50 çështje, janë shqyrtuar mbi ankimin e Prokurorit (46 çështje penale kundër vendimit që gjykata e faktit ka zbutur masën e sigurimit të kerkuar nga prokurori dhe 4 ankime kundër zëvendësimit të masës së sigurimit) .
- 271 çështje janë shqyrtuar mbi ankimin e të pandehurve.

(Shenim: Ankimet mund të jenë ushtruar edhe nga të dy palët njëkohësisht).



Për vitin 2020, rezulton se ka një ulje të numrit të çështjeve me objekt vleftësim ose caktim mase sigurimi personal, në krahasim nga viti 2019, (me 14 çështje më pak).

II. Mbi dinamiken, gjëndjen dhe drejtimit e kriminalitetit sipas çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata e Apelit me pjesëmarrjen tonë.

Në Gjykatën e Apelit Shkodër, janë përfaqësuar në gjyqë **198 çështje themeli gjithësejt**, me **263** të pandehur nga këta me **110** të arrestuar, krahasimisht me vitin e kalur, 186 çështje më pak.

Vepra penale kundër personit, jetës dhe shëndetit” (Neni 76 – 91 të Kodit Penal) **16** çështje.

Krahasuar me një vit më parë, numri çështjeve është ulur me **12** çështje pasi në vitin 2019 numri i këtyre çështjeve ishte 28.

Vepra penale të trafikimit të paligjshëm” (Neni 110, 114, 141/a, 283, 284 të Kodit Penal) **19** çështje.

Veprat penale të parashikuara nga neni 283 dhe 284 të K.Penal, përkatësisht me **14** çështje (neni 283) dhe **4** çështje (neni 284).

Ka patur një ulje të këtyre çështjeve në krahasim me vitin 2019, përkatësisht kanë qënë **29** çështje (neni 283) dhe **5** çështje (neni 284).

“Vepra penale të dhunës në familje” (Neni 130/a i K.Penal) **43** çështje. Krahasuar me një vit më parë, numri çështjeve për vitin 2019 ishte **39** çështje, pra me **4** çështje më shumë këtë vit raportues.

“Vepra penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike” (Neni 134 – 143 të Kodit Penal) **29** çështje, (ku **10** çështje janë për veprën penale të parashikuar nga neni 137 i K.Penal).

Krahasuar me një vit më parë, ku numri çështjeve të gjykuara për vitin 2019 ka qënë **64** çështje, pra me **35** çështje më pak.

-Veprat penale të parashikuara nga neni 197 dhe 199/a, **5** çështje, Krahasuar me një vit më parë, numri çështjeve për vitin 2019 ishte **30** çështje, pra me **25** çështje më pak.

“Vepra penale kundër autoritetit shtetëror”

- **12** çështje, për nenin 278/2,3,4 i Kodit Penal.
- **6** çështje, për nenin 248, 258, 259 i Kodit Penal.
- **12** çështje, për nenin 290 i Kodit Penal.
- **14** çështje, për nenin 291 i K.Penal.
- Gjithsej **44** çështje.

Krahasuar me një vit më parë, ka rënie pasi, numri i çështjeve të gjykuara për vitin 2019 ishte **69** çështje, pra me një rënie prej **25** çështjesh më pak.

Duke krahasuar dinamiken e veprave penale për vitin 2020, në raport me ato të vitit 2019 (të

çështjeve të gjykuara) , konstatohet se:

- Kemi një ulje të veprave penale në fushën e krimit për veprat penale të trafikimit të paligjshëm, e konkretisht neni 283, 284 të K.Penal (me **8** çështje më pak).
- Kemi një ulje të veprave penale në fushën e drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt neni 291 i K.Penal (**12** çështje më pak) .
- Kemi një ulje për vepra penale kundër pasurisë dhe sferës ekonomike.
- Kemi një ulje për veprën penale “Ndertim i paligjshëm” **5** çështje nga **30** çështje që ishin në vitin 2019
- Kemi një ulje për veprat penale të shpërdorimit të detyrës (**10** çështje më pak).
- Në vitin 2019 janë shqyrtuar **12** çështje për veprën penale të vrasjes; Ndërsa në vitin 2020 janë shqyrtuar **7** çështje për veprën penale të vrasjes, sipas nenin 78 K.Penal janë shqyrtuar **5** çështje, sipas neni 79/a dhe neni 79/ë, nga **1** çështje. Për vitin që po analizojmë, rezulton një ulje prej **5** çështjesh më pak nga viti i kaluar.

Lidhur me çështjet administrative-penale, konstatojmë se janë shqyrtuar 260 çështje.

Një numër më i ulur se në vitin 2019 (me 105 çështje më pak),

Apelimet për çështjet e themelit sipas rretheve, janë të shpërndara në këtë mënyrë:

❖ Prokuroria e Rrethit Shkodër:

- Me **122** çështje ose rreth 60 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **163** të pandehur, nga të cilët **70** të arrestuar.

Nga këto, 37 çështje kanë ardhur mbi apelin e Prokurorit; janë përkrahur nga Prokurori **14 apele**, në **3** raste është kërkuar lehtësim i pozitës, **2** raste për prishje vendimi dhe është hequr dorë në **18** prej tyre pasi shumë prej çështjeve kanë qënë për veprat penale 291 dhe 137 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e Prokurorit në **14** raste ndërsa në **76** raste ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, **4** raste lehtësu pozitën dhe në **1** rastë prishje e vendimit dhe pushim i çështjes.

Ndaj këtyre vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkodër, nga ana e prokurorëve janë ushtruar **7 rekurse** në Gjykatën e Lartë.

❖ Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë:

Me **49** çështje, ose 25 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **62** të pandehur, nga të cilët **25** të arrestuar.

Apele të Prokurorit **11 çështje**, - 7 për pafajësi, 2 për ndryshim kualifikimi dhe 2 për dhenie mase dënimi ma të butë. Eshtë hequr dorë nga apeli në **4** raste. Prokurori ka kërkuar lëninën në fuqi të vendimit në **36** raste dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi **30** raste, lehtësuar pozitën e të pandehurit në **5** raste dhe në **1** rastë prishje vendimi. Kërkesa e prokurorit për të rënduar pozitën në 6 raste. Nga këto 4 raste ka lënë në fuqi vendimin dhe në 2 raste, ndryshim vendimi dhe rendim pozite. Në 3 raste prokurori ka kërkuar lehtësimin e pozitës së pandehurit dhe gjykata ka vendosur 1 rastë lehtësim pozite dhe 2 raste lëninën në fuqi të vendimit. (shif tabelën përkatëse).

❖ **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës:**

Me **9** çështje, ose **5 %** të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **11** të pandehur, nga të cilët **3** të arrestuar.

Apel të Prokurorit **4 çështje**, - 3 për pafajësi, 1 për dhenie mase dënimi ma të butë. Eshtë hequr dorë nga apeli në **1** raste. Prokurori ka kërkuar lënie ne fuqi te vendimit ne **5** raste dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi **3** raste, lehtësuar pozitën e te pandehurit në **2** raste. Kërkesa e prokurorit për ndryshim vendimi dhe rëndim pozite në 3 raste. Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi 3 raste.(shif tabelën përkatëse)

❖ **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë :**

Me **9** çështje, ose **5 %** të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **17** të pandehur, nga të cilët **4** të arrestuar.

Apel të Prokurorit **3 çështje**, - 2 për pafajësi, 1 për dhënie masë dënimi ma të butë. Eshtë hequr dorë nga apeli në **2** raste.


Prokurori ka kërkuar lënie ne fuqi të vendimit ne **6** raste dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi **4** raste, lehtësuar pozitën e të pandehurit në **1** rastë dhe prishje vëndimi në 1 rast. Kërkesa e prokurorit për ndryshim vëndimi dhe lehtësuar pozitën në 1 rast. Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vëndimin (shif tabelën përkatëse).

❖ **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë :**

Me **9** çështje, ose **5 %** të numrit të përgjithshëm të çështjeve të shqyrtuara në apel, me **10** të pandehur, nga të cilët **1** të arrestuar.

Apel të Prokurorit **5 çështje**, - **3** për pafajësi, **2** për dhenie mase dënimi ma të butë. Eshtë hequr dorë nga apeli në **3** raste. Prokurori ka kërkuar lënie ne fuqi te vendimit ne **4** raste dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi **4** raste. Kërkesa e prokurorit për ndryshim vendimi dhe rëndim pozite në 1 ratë, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi. Kërkesa të prokurorit për lehtësim pozite 1 rastë dhe gjykata e ka lehtësuar pozitën për këtë rast (shif tabelën përkatëse)

Tabela më poshtë pasqyron raportin e numrit të çështjeve të themelit të ndara sipas rretheve.



Rastet e heqjes dorë nga ankimi,

Në total, nga ana e Prokurorëve të Apelit, është hequr dore nga ankimi në 28 raste. Heqja dore nga ankimi ka qënë kryesisht lidhur me aplikimin e Nenit 59 të K.Penal, për veprat penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, për veprat penale të parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal.

Ne lidhje me heqjen dorë nga ankimi është marrë parasysh ankimi i Prokurorëve të cilet kanë ushtruar ankim lidhur me masën e dënimit kryesisht për veprën penale *Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt, nenin 291 të K.Penal, apo ajo e „Vjedhja e enërgjisë elektrike...“ sipas nenit 137/1 i K.Penal.*

Prokurorët e shkallës së parë, në ankimin e tyre kanë kundërshtuar aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe në lidhje me deklarinimin fajtorë të të pandehurve, kanë qënë dakort me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Ankime ndaj vendimeve të Gjykatës së Faktit të ushtruar nga të pandehurit:

Rezulton se mbi ankimin e të pandehurve janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër **175** çështje.

Kërkesat e Prokurorisë, për çështjet e shqyrtuara në Gjykatën e Apelit, kanë qënë si më poshtë:

- Në **2** raste është kërkuar prishje e vendimit dhe kthim i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Faktit. Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën në 2 raste.
- Në **8** raste është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit. Gjykata e Apelit ka vendosur sipas kërkesës tonë për 3 raste, ndërsa në 5 raste është vendosur lënie në fuqi e vendimit nga kjo Gjykatë .
- Në **136** raste, nga ana jonë është kërkuar lënie në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur në 117 raste lënie në fuqi të vendimit (ose rreth 86% të rasteve).

Në 16 raste është vendosur ndryshimi i vendimit (lehtësimi i pozitës së të pandehurve, pra rreth 11 % e rasteve). Në 2 raste është vendosur prishje e vendimit dhe pushim i çështjes ose 3 % e kërkesave dhe në 1 të tjera është vendosur prishje e vendimit dhe kthim i akteve për rigjykim, ose 1% e tyre.

- Në 24 raste nga ana jonë është kërkuar ndryshimi i vendimit (rëndimi i pozitës së të pandehurve), nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur në 15 raste lënie në fuqi të vendimit.

Në 4 raste ka ndryshuar vendimin, duke rënduar poziten e të pandehurve, në 4 raste ka vendosur ndryshimin e vendimit (lehtësimin e pozitës së të pandehurve), në 1 rast ka vendosur prishje e kthim aktesh.

- Në 28 raste Prokurori ka kërkuar heqje dorë nga ankimi, dhe Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

III. Mbi masat e sigurimit.

Krahas përgatitjes dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve të themelit, një kujdes të veçantë i kemi kushtuar pjesëmarrjes dhe përfundimit të çështjeve me objekt caktimin e masave të sigurimit.

Për periudhën objekt analize, nga Gjykata e Apelit janë shqyrtuar gjithsej dhe përfaqësuar në Gjykatën e Apelit 272 çështje, me 387 të dyshuar, nga të cilat 50 mbi apelin e Prokurorit dhe 271 shqyrtuar mbi apelin e të dyshuarve.

Nga çështjet me objekt shqyrtimin e masave të sigurimit me apel të Prokurorit, Gjykata e Apelit ka vendosur në 21 raste miratim vendimi; në 8 raste rëndim pozitë; në 16 raste masë më të butë dhe në 12 raste mospranim ankimi pasi ka hequr dorë Prokurori, për shkak të pabazueshmërisë së ankimit dhe konkretisht disa nga shkaqet për të cilat nga ana jonë është hequr dorë, kanë qënë:

- është shuar masa e sigurimit nga Gjykata e Shkallës së Parë.
- ka përfunduar gjykimi në themel dhe të pandehurit janë dënuar me kusht ose dënim tjetër penal.
- në disa raste është zëvendësuar masa e sigurimit nga Gjykata e Shkallës së Parë por, shumica e heqjes dorë nga ankimi ka qënë për arsye se ndërkohë që gjykohej çështja në Apel, kishte përfunduar afati i masës së sigurimit të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë si dhe rastet kur ishte caktuar masë tjetër siguri, dhe nga ana e Prokurorit ishte ankimuar përsëri ky vendim.

Gjatë periudhës raportuese:

-Për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 të K.Penal – 5 çështje, me 9 të dyshuar. Ndaj vendimit të Gjyk.Shk.Parë, ka ushtruar ankim Prokurori në 1 rast dhe të dyshuarit në 5 raste.

Për 1 rast Prokurori i Apelit ka kërkuar ndryshim-vendimi dhe Gjykata e Apelit ka vendosur, për 1 rast ndryshim-vendimi (masë më të butë). Për 4 raste Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim-vendimi dhe Gjykata e Apelit ka vendosur, për 3 raste miratim vendimi dhe në 1 rast shfuqizim vendimi.

-Për veprën penale “Korrupsion pasiv i punonjësve që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar 259 të K.Penal - 1 çështje, me 1 të dyshuar. Kundër vendimit të Gjyk.Shk.Parë, ka ushtruar ankim i dyshuari dhe Gjykata ka vendosur miratim vendimi.

- Për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 K.Penal, 45 çështje, me 74 të dyshuar. Kundër vendimit të Gjyk.Shk.Parë, ka ushtruar ankimi Prokurori në 9 raste dhe të dyshuarit në 45 raste.

Hequr dorë prokurori në 2 raste, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Për 7 raste Prokurori i Apelit ka kërkuar ndryshim-vëndimi, dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në 6 raste dhe 1 rast arrest në shtëpi dhe Gjykata e Apelit ka vendosur, për 4 raste ndryshim-vëndimi, caktimin e masës “Arrest në burg”; në 2 raste ka zbutur masën e sigurimit, në 1 rast ka vendosur vendosur miratim vendimi dhe në 1 rast shfuqizim vendimi.

Për 36 raste Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim-vëndimi dhe Gjykata e Apelit ka vendosur, për 28 raste miratim vëndimi dhe për 8 raste ndryshim vëndimi, duke zbutur masën e sigurimit.

-Për veprën penale të “Kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga Neni 284 i K.Penal - 14 çështje, me 32 të dyshuar. Kundër vendimit të Gjyk.Shk.Parë, me 15 ankime të të dyshuarve.

Për 13 raste Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim-vëndimi dhe Gjykata e Apelit ka vendosur, për 12 raste miratim vëndimi; për 1 rast ndryshim vëndimi, duke zbutur masën e sigurimit.

Për 1 rast Prokurori i Apelit ka kërkuar ndryshim-vëndimi, dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe Gjykata e Apelit ka vendosur caktimin e masës “Arrest në burg”

Sipas rretheve, apelet ndaj masave të sigurimit ndahen:

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër 155 çështje me 222 të pandehur nga keto 29 apele te prokurorit dhe 158 te te pandehurve, është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në 8 prej tyre, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.


Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër 75 çështje me 96 të pandehur. Me apele te prokurorit në 15 raste dhe të 72 të pandehurve. Eshtë hequr dorë nga apeli i Prokurorit në 2 prej tyre, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër 29 çështje me 52 të pandehur. Me apele te prokurorit 3 dhe 31 te të pandehurve. Eshtë hequr dorë nga apeli i Prokurorit në 1 prej tyre, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër 8 çështje me 8 të pandehur ku ankimet janë vetëm të të pandehurve .

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër 5 çështje me 9 te pandehur. Apele te prokurorit 3 dhe 2 te pandehurve, është hequr dorë nga apeli i Prokurorit në 1 prej tyre, Gjykata ka vendosur mospranim ankimi.

Tabela më poshte pasqyron raportin e numrit të masave të sigurimit të ndara sipas rretheve.



Ndaj këtyre vendimeve është ushtruar 1 rekurs (për njësim praktike) në Gjykatën e Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit.

Duke parë të dhënat që rezultojnë nga shqyrtimi në Gjykatën e Apelit të çështjeve me objekt vlerësim e caktim masë sigurimi, mbeten me përhapje të gjerë veprat penale të dhunës në familje (28), vepra penale kundër pronës (27), mbajtja e lëndëve narkotike apo kultivimi i bimëve narkotike, neni 283 K.Penal dhe neni 284 K.Penal (59), mbajtja pa leje e armëve luftarake (16); ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve (10) ; shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (21); shpërdorim detyrë (5); drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt (5), dhe vjedhje me dhunë (1); Mashtim (5); Ushtrim pa liçense i veprimtarisë financiare(4); Kundërshtim i punonjësit të Policisë(7).

◆ **Të dhëna mbi ekzekutimet e vendimeve penale.**

Gjatë vitit 2020, janë lëshuar gjithsej 85 urdhëra-ekzekutimi, të cilat kanë qënë urdhëra ekzekutimi për lirim të menjëhershëm, për arrestime kur është rënduar masa e sigurimit, si edhe për ekstradimet duke urdhëruar Prokuroritë përkatëse dhe Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, për vënien në ekzekutim të këtyre urdhërave etj..

Cilësoj se urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë në kohe dhe brënda afateve ligjore nga ana e Prokurorëve të Apelit.

Konkretisht për vitin 2020, janë nxjerrë 84 urdhër ekzekutimi, nga këto: Prokurori Lazer Çardaku 50, Prokurori Brahim Dragjoshi 31 dhe Prokurori Elvin Gokaj 3.

Ngarkesa e Prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Shkoder, është si më poshtë:

Prok/ Lloji i çështjes	Masa sigurimi	Çështje Themeli	Çështje Admin.	Total
------------------------	---------------	-----------------	----------------	-------

Brahim Dragjoshi	119	65	111	295
Elvin Gokaj	13	12	11	36
Lazer Çardaku	140	120	139	399
Total	272	195	260	730

Për çdo problematike të rezultuar nga gjykimi i çështjeve, së bashku me njoftimin e vendimit të marrë nga Gjykata e Apelit Shkodër, Prokuroria e Apelit Shkodër, ka vënë në dijeni prokuroritë e rretheve dhe drejtuesit e tyre

IV. POLITIKA E DËNIMIT:

Për veprat penale të cilat karakterizohen, si nga numri i madh i regjistrimit të proçedimeve penale për to, ashtu edhe nga specifika që paraqesin, është ndjekur në përgjithësi kjo politikë duke mbështetur në përgjithësi qëndrimin tonë ligjor, ku është bërë kujdes i veçantë nga ana jonë, zbatimi i një politike të drejtë dënimi, në funksion të një lufte efektive ndaj kriminalitetit aktual si dhe parandalimit të tij.

Nëpërmjet kërkesave tona objektive e të argumentuara, jemi përpjekur për ti „imponuar“ kështu Gjykatës së Apelit të japë llojë dhe masa dënimi, në përputhje me kriteret ligjore dhe gjëndjen e kriminalitetit në rrethet dhe zonat, ku ai respektivisht është shfaqur.

Në funksion të idesë që faji të mos shpëtojë pa u dënuar dhe pafajësia të mos vuajë padrejtësisht, jemi përpjekur dhe vazhdojmë të përpiqemi të proçedojmë duke dhënë goditje në drejtim të forcimit të politikës së dënimit, sidomos ndaj veprave penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore si dhe ndaj atyre me përhapje dhe frekuencë të lartë. Vlen të theksohet se për çështjet që kanë ardhur me vendim pafajsie nga Gjykatat e Shkallës së Parë, kemi hasur vështirësi për zbatimin e nenit 427 të K.Pr.Penale, për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja. Pasi me ndryshimet ligjore Gjykata e Apelit, nuk mund të deklarojë fajtor një të pandehur i cili është deklaruar i pafajshëm në Gjykatën e shkallës së Parë me të njëjtat prova të cilat janë shqytuar gjatë gjykimit në shkallë të parë. Megjithatë vlen të theksohet se Gjykata e Apelit Shkodër ka proceduar me dy praktika të ndryshme, në disa raste ka pranuar kërkesën e Prokurorit për rimarrjen e provave qoftë atyre egzistuese apo të reja duke deklaruar fajtor të pandehurit të cilët gjatë gjykimit në shkallë të parë janë deklaruar të pafajshëm. Dhe në raste të tjera ka lënë në fuqi vendimin e pafajsisë me arsyetimin se nuk ka prova të reja. Në lidhje me këtë fakt nga ana e jonë është bërë rekurs ne Gjykatën e Lartë për njësim praktike.

Gjatë vitit një vëmendje e veçantë ju është kushtuar gjykimit të **çështjeve administrative penale**. Në të gjitha rastet prokurori i apelit ka përkrahur ankimet e prokurorit lidhur me lirimet parakohe me kushte. Në dy raste nga ana e Gjykatës së Apelit është pranuar ankimi i prokurorit dhe të dënuarit janë rikthyer qelisë.

Duhet cilësuar se Gjykata e Apelit jep vendime në dhomë këshillimi pa pjesmarrjen e palëve, lidhur me çështjet administrative penale sic janë kërkesat për dërgim të çështjes në gjyqë, pushimin e akuzues apo çështje, rishkimit të vendimit etj. Pavarësisht kësaj nga ana e Jonë, menjëherë janë marrë shkurtimet e vendimeve dhe njoftuar prokurorit e rretheve përkatëse. Duhet theksuar se ka një rritje të çështjeve të gjykuara me objekt kthimin e akteve, shfuqizimin e vendimeve të mosfillimit, pushimit të çështjeve, dërgimit të çështjes në gjyqë, ku gjykata e shkallës së parë ka vëndosur ndryshe nga kërkesat e prokurorit. Çmojë se kërkohet më shumë vlerësim në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore të gjithëanshme me qëllim arritjen e një vendimarrje sa më të drejtë në kohë dhe mënyrë ligjore.

V. BASHKËPUNIMI ME PROKURORITË E RRETHEVE

Marrëdhëniet ndërmjet Prokurorive janë domosdoshmërisht të nevojshme pasi i shërbejnë më së miri zgjidhjes së problematikës së hasur në punën e përditshme, duke kërkuar zgjidhje ligjërish dhe bashkëpunimit me prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore në koordinimin e hetimeve dhe dhënien e informacioneve që mund të nevojiten.

Përsa i përket Prokurorive të rretheve Shkodër, Lezhë, Kukës, Pukë, Tropojë kemi pasur kontakte të herëpashershme dhe kjo i ka shërbyer punës në lidhje me kualifikimin, vendimarrjen, për të dhënë një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore për rastet objekt gjykimi.

Janë ndjekur me kujdes të veçantë mënyra e përfundimit të çështjeve të cilat janë ankimuar si nga të pandehurit ashtu edhe nga ana e prokurorëve.

Me kujdes të veçantë janë ndjekur mënyra e përfundimit të çështjeve të cilat janë ankimuar si nga të pandehurit ashtu edhe nga ana e Prokurorëve. Për çdo vendim të Gjykatës së Apelit, menjëherë dhe zyrtarisht nga ana jonë, i është dërguar shkurtimi i vendimit Prokurorisë përkatëse.

Nga ana e Prokurorëve janë dërguar në kohë kopje të ankimeve të bëra, duke bërë të mundur që nga ana e Prokurorëve të Apelit të informohemi në kohë lidhur me qëndrimin e tyre ndaj vendimeve të Gjykatës së Faktit. Konstatohen se gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ankime të shumta të bëra nga Prokurorët për rritje të masës së dënimit, në krahasim me vitin 2019 ku megjithëse diferenca mes kërkesës së Prokurorit dhe vendimit të Gjykatës kanë qënë të vogla, një gjë e tillë shtonte artificialisht volumin e punës.

Gjithashtu është evidentuar shpeshherë edhe nga Gjykata e Apelit, mungesa e informacionit që Prokurorët duhet ti dërgojnë çdo dy muaj gjykatës për zbatimin e vendimit të arrestit, sipas nenit 246/6 i K.P.Penal, veprim i cili është bërë shkak për kërkesat shpeshta e të dyshuarve lidhur me zëvendësimin të këtyre masave.

Duhet bërë kujdes në paraqitjen e ankimit konform rregullave të përcaktuara në ligj pasi Gjykata e Apelit Shkodër në disa raste ka vëndosur mospranimin e ankimit për shkak se nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit (neni 420, gërma “c”, të K.Pr.P).

VI. BASHKËPUNIMI ME GJYKATËN E APELIT SHKODËR

Bashkëpunimi me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, ka qenë institucionale dhe i vlefshëm. Gjyqtarët kanë qënë të gatshëm dhe të disponueshëm në çdo kohë për gjykimet në themel, kërkesa që kanë të bëjnë me vlefhtësimin e masave të sigurimit, për lejimin e veprimeve të përgjimit, riçeljen e shqyrtimit gjyqësor etj...

Gjykata ka ruajtur solemnitetin e saj si arbitër mes palëve të barabarta dhe nga ana jonë është respektuar pozicioni i saj. Për zgjidhjet që janë vlerësuar nga ana e Jonë në kundërshtim me kërkesat e prokurorëve është ndjekur rregullisht rruga ligjore, pra janë ushtruar rekurse dhe në disa raste për njësimin e praktikës.

VII. MARRËDHËNIET ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

Në lidhje me publikun është për t'u theksuar fakti se nga ana e prokurorëve është mundësuar vazhdimisht pritja me korrektësi e ankesave, shqetësimeve të qytetarëve duke u munduar t'u jepet një zgjidhje sa më e shpejtë, e drejtë dhe ligjore. Natyrisht që parashtrimi i problemeve nga ana e publikut nuk është kufizuar vetëm në një ditë të veçantë pasi stafi ynë gjatë gjithë kohës është në ushtrim të detyrës së tij.

Brënda kuadrit të respektim edhe të të drejtave të qytetarëve për informim, jemi munduar të ruajmë një marrëdhënie sa më korrekte me median, ku çdo informacion, lidhur me publikimin e vendimeve të Gjykatës i kemi vënë në dispozicion për faktin se vendimet nuk përbëjnë sekret hetimor. Jemi munduar pa cënuar prezumimin e pafajësisë, të drejtën private si dhe në mbrojtje të të drejtave të të miturve.

Një çështje problematike në raportet me mediat, mbetet pasqyrimi i të dhënave dhe informacioneve të fazës së hetimeve paraprake, të marra nga burime të ndryshme nga prokuroria. Shpesh cënohet parimi se çdo person është i pafajshëm derisa të shprehet gjykata me një vendim fajësie të formës së prerë.

VIII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

Në fund të vitit 2020, dhe fillimin e vitit 2021, organika e kësaj prokurorie, përbëhet nga 7 punonjës.

Drejtues	1
Zëvendësdrejtues	1
Prokuror	2
K/Sekretare	1
Sekretare pranë Prokurorëve	1
Shofer	1

Aktualisht ushtrojnë detyrën Drejtuesi i Prokurorisë dhe një Prokuror.

Në zbatim nenit 53 të ligjit nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr. 3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, nga drejtuesi i kësaj prokurorie, është urdhëruar ndarja e çështjeve me short manual, sipas listës së gatishmërisë, referuar ngarkesës së barabartë të çështjeve, veprave penale.

Tabela organike numerike e Prokurorisë, që ushtron funksionin aktualisht:

Drejtues	1
Prokuror	1
K/sekretare	1
Sekretare	1
Shofer	1
Gjithsej	5

Në përputhje me ngarkesën mëndojmë se në Prokurorinë e Apelit Shkodër, numri i Prokurorëve është i pamjaftueshëm për të përballuar volumin e punës të pasqyruar në këtë raport, pasi në organikë është përcaktuar që në Prokurorinë e Apelit Shkodër do të ushtrojnë funksionin e tyre 4 Prokurorë.

Gjithashtu është kërkuar që në organikë të vëndoset edhe një sekretarë pasi volumi i punës në Prokurorinë e Apelit është i madh që të përballohet vetëm me një sekretar pranë prokurorëve.

Kushtet në të cilat ushtron funksionet i gjithë stafi i kësaj Prokurorie, specifikisht akomodimi në zyra të mira, ka krijuar kushte dhe ka shërbyer si një faktor që ndikon drejtpërdrejt në punën e përditshme.

Me gjithë ngarkesën e punës dhe situatën e pandemisë nga covid-19, janë ruajtur marrëdhënie të vazhdueshme me Shkollën e Magjistraturës. Kjo e fundit ka dërguar programet e trajnimeve të cilat janë plotësuar nga prokurorët. Këta të fundit kanë marrë pjesë në kurset e trajnimit të zgjedhura prej tyre e të organizuara në Shkollën e Magjistraturës. Gjithashtu prokurorët kanë marrë pjesë në aktivitete të tjera si sesione trajnimi, tryeza të rrumbullakëta, konferenca etj,...

IX. RAPORTI FINANCIAR

Në Prokurorinë e Apelit Shkodër gjatë vitit 2020 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike – financiare janë çelur fondet si më poshtë:

Buxheti total për vitin **2020** ka qënë në masën **11.936.000** lekë, ndërsa realizimi i këtij buxheti ka qënë në masën **11.563.004**, pra rreth **97%**.

Të ndarë në zëra paraqitet si më poshtë:

Në zërin **600**, fondi ka qënë **10.250.000** lekë, ndërsa realizimi ka qënë në masën **10.146.793** lekë.

(Shënim: Një Prokuror është paguar 75% të pagës).

Në zërin **601** fondi ka qënë **1.080.000** lekë, ndërsa realizimi ka qënë në masën **1.002.009** lekë.

Në zërin **602** ka qënë **606.000** lekë ndërsa realizimi ka qënë në masën **414.202**.

(Shënim: Shpenzimet operative kanë qënë me të ulëta nga planifikimi, kjo për shkak të numrit më të vogël të çështjeve të përfunduara, krahasuar me 1 vit më parë).

Janë shpenzuar në total **11.563.000** lekë.

Niveli i shpenzimeve të pasqyruara më sipër janë rakorduar me degën e thesarit Shkodër, çdo muaj, sipas situacionit analitik, të mbajtur sipas standartit të përgatitur nga Ministria e Financave, situacion i cili është përcjellur çdo muaj në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këtë vitë, fondi në zërin **600** dhe **601**, ka qënë pothuaj njësoj me vitin 2019 pasi në Prokurorinë e Apelit Shkodër janë paguar dy prokuror, njëri prej të cilëve në zbatim të Ligjit 84/2016 neni 62 pika 1, është paguar me 75% të pagës.

Regjistrat në Prokurorinë e Apelit Shkodër, deri në datën e miratimit të Rregullores standart nr. 6 datë 25.01.2021, janë mbajtur në mënyrë të atillë që të rakordojme me regjistrat që disponon Gjykata e Apelit Shkodër. Këto regjistra janë të ndara në:

- 1-Regjistër për çështjet e themelit.
- 2-Regjistër për vleftësim dhe caktim masa sigurimi.
- 3-Regjistër për çështjet administrative.

Në bazë të këtyre regjistrave janë plotësuar çdo muaj të dhënat statistikore, të cilat janë përcjellë në rrugë elektronike në Prokurori të Përgjithshme, një herë në muaj (për çështjet e themelit), si dhe çdo 3 muaj për të gjitha çështjet në total.

Sa i takon *sigurisë* së institucionit, Prokuroria e Apelit Shkodër ushtron veprimtarinë e saj në godinën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e për rrjedhojë dhe prokurimet lidhur sigurinë e godinës zhvillohen nga Prokuroria e Rrethit Shkodër.

X. TË DHËNA STATISTIKORE PËR SECILIN PROKUROR

Prokurori Brahim Dragjoshi

Ka ushtruar funksionin e Prokurorit në Prokurorinë e Apelit Shkodër që nga viti 2002 deri me 16.11.2020. Aktualisht prokurori Brahim Dragjoshi, nuk ushtron më funksionin e Prokurorit pasi nuk është konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Puna e tij në këtë prokurori ka qënë voluminoze pasi ka konsistuar në përfaqesimin e çështjeve të themelit në Gjykatë, ashtu edhe në masat e sigurimit. Është treguar i gatshëm në kryerjen e detyrës, duke mos u bërë shkas për shtyrjen e gjyqëve për mungesën e tij. Gjithashtu ka nxjerrë në kohë udhërat e ekzekutimit të menjëhershme duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Marrëdhëniet me prokurorët e tjerë, stafin administrativ, ka qënë gjithmonë korrekte.

Nga ana e Prokurorit Brahim Dragjoshi, janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli.....65 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi.....119 çështje
- Çështje të tjera.....111 çështje
- Gjithsej.....295 çështje**

Prokurori Elvin GOKAJ

Ka ushtruar funksionin e tij në Prokurorinë e Apelit Shkodër që nga viti 2014. Nga viti 2016-2019 ka qenë drejtues i kësaj prokurorie deri në Korrik të vitit 2019. Ka ndjekur programin e trajnimit një vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe me vendim të Komisionit të Pavarur të Apelit me 18.11.2020 është kthyer në detyrën e Prokurorit pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër .

Është treguar i gatshëm në kryerjen e detyrës, duke mos u bërë shkas për shtyrjen gjyqever për mungesën e tij. Gjithashtu ka nxjerrë në kohë urdherat e ekzekutimit të menjëhershme duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Marrëdhëniet me prokuroret e tjerë, stafin administrativ, me drejtuesin e institucionit kanë qënë gjithmonë korrekte.

Për vitin 2020 (nga data 18.11.2020 deri me 31.12.2020) nga Prokurori **Elvin Gokaj** janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:

- Çështje themeli..... 12 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi..... 13 çështje
- Çështje të tjera..... 11 çështje
- **Gjithsej..... 36 çështje**

Prokurori Lazer Çardaku

Ka ushtruar funksionin e Prokurorit në Prokurorinë e Apelit Shkodër që nga muaji Korrik 2019 (me vendim të KLP-së për caktim të përkohshëm). Me vendimin nr.265 datë 17.11.2020 të KLP-së prokuror Lazer Çardaku është caktuar përkohësisht në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër. Gjatë kësaj periudhe ka konsistuar në përfaqësimin e çështjeve të themelit në Gjykatë ashtu edhe në masat e sigurimit.

Nga ana e Prokurorit Lazer Çardaku, janë përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër këto çështje penale:


- Çështje themeli.....120 çështje
- Vleftësim dhe caktim mase sigurimi.....140 çështje
- Çështje të tjera.....139 çështje
- **Gjithsej.....399 çështje**

Numri i total i çështjeve të ndara sipas Prokurorëve për vitin 2020.

Tabela grafike e ndarjes së çështjeve.

Prokurori	Nr.i çështjeve
Brahim Dragjoshi	295

Elvin Gokaj	36
Lazer Çardaku	399



Së fundi, por për nga rëndësia mëndoj që përbën një nga reflektimet në punën e secilit, janë disa nga problematikat e konstatuara gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër, dhe konkretisht:

Së pari:

1. Në mjaft raste, **ankimet paraqiten pa shkaqe ligjore** duke përsëritur konkluzionet dhe dispozitivin, me arsyetimin se vendimi nuk është zbardhur akoma nga gjykata e faktit. Ndonëse kalojnë muaj të tërë, nuk bëhet ankim shtesë sipas kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 415/2 e K.Pr.Penale.
2. Në pak raste nga ana e prokurorit bëhet **apel kundërshtues** sipas kërkesave ligjore të nenit 423 K.Pr.Penale. Çmujë se apeli kundërshtues është një mjet apeli (ankimi) që vë në pozita ligjore si perfaqësuesin e akuzës në Gjykatën e Apelit dhe këtë të fundit.
3. Ndonëse gjykimi i çështjes ka përfunduar me pafajësi, në ankimin e tij Prokurori nuk kërkon **përsëritja e shqyrtimit gjyqësor** apo marrja e provave të reja, referuar nenit 427 K.Pr.Penale pasi, sipas kësaj dispozite (pika 4), Gjykata e Apelit nuk mund ta deklarojë të pandehurin fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave, marrë në gjykim në shkallën e parë.
4. Ndonëse raste të rradha, kemi konstatuar, **ankime jashtë afatit proceduriale**, gjë e cila ka sjell automatikisht dhe mospranim të ankimit nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër. Çmuj se raste të tilla nuk duhet përsëritur.
5. **Problematika** kanë rezultuar në lidhje me **aplikimit të nenit 59 K.Penale**, pezullimi ekzekutimit të dënimit me burgim. Në mjaft raste është konstatuar se nga ana e prokurorit të çështjes nuk është urdhëruar ekzekutimi i vendimit të gjykatës për dënimin e dhënë me kusht, si detyrim ligjor që

rrjedh nga neni 59/4 i K.Penale, ku thuhet se ... *Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim...* Në gjykimin e këtyre çështjeve, kjo ka sjelle jo në pak raste, kërkesa e të dënuarve për shuarjen e masës së dënimit për neglizhencë të prokurorit...(dy raste Gjykata Lezhë)

6. Ndonëse deri tani kemi patur një rast të vetëm (*Prokurorise Kukës, rasti i pandehurit Florian Lugja çështje e vitit 2015 i denuar për 283/2 K.Penal, i arrestuar, hetuar, gjykuar dhe vënë në ekzekutim vendimi i gjykatës me këtë emër por, autorë kishte rezultuar vëllai i tij Emanuel Lugja*), del e domosdoshme t'i kushtohet vëmendje verifikimit të pandehurit, në referim të dispozitës së parashikuar nga neni 295, 296 të K.Pr.Penale "**Identifikimi i personit nën hetim**".
7. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër, ndonëse raste sporadike, janë konstatuar se nga ana e prokurorit të çështjes, nuk tregohet kujdes kur kemi të bëjmë me **provat materiale të sekuestruara** gjatë hetimit paraprak për ti kërkuar Gjykatës në përfundim të gjykimit, kthimin apo konfiskimin e tyre sipas nenit 190 K.Pr.Penale dhe nenit 36 K.Penal.Raste të kësaj natyre për provat material janë konstatuar dhe në disa çështje të tjera. **Pra, kërkohet që në përfundim të gjykimit prokurori i çështjes të shprehet për fatin e provave dhe sendeve të sekuestruara apo produkteve që rrjedhin nga vepra penale.**
8. Nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër me të drejtë, jo në pak raste ka konstatuar vleftësimin e **paligjshëm të ndalimeve apo arrestimeve** që kanë bërë opgj-re me iniciativë, në keqinterpretim të ligjit procedural penale dhe nuk rezulton të ketë ndërhyrje të prokurorit,... Çmojmë se nga ana e prokurorit të çështjes dhe Drejtuesit të Prokurorisë, duhet të jetë objekt analize çdo rast i tillë. Vlen të theksojmë se ka patur raste që opgj-re, kanë bërë ndalime edhe për kanosje apo vjedhje, sipas paragrafit parë të nenit 134/1 i K.Penale, kur dispozita e parashikuar nga neni 253 K.Pr.Penale përcakton shumë qartë, kushtet dhe kriteret kur bëhet ndalimi qoftë dhe me iniciativë nga opgj-re.
9. Në disa raste, Gjykata e Apelit Shkodër, me të drejtë, ka konstatuar se nga ana e prokurorit nuk **respektohen afatet procedurale të vendimmarrjes** siç është ajo e mosfillimit të procedimit penal brënda 15 ditëve nga data e rregjistrimit, duke sjelle shfuqizimin e vendimit të mosfillimit dhe urdhërimin e rregjistrimit të procedimit penal, kryerjen e veprimeve hetimore. Sjellim në vëmendje se afati procedural fillon nga momenti i regjistrimit të kallëzimit në regjistrin përkatës të prokurorisë.
10. Lidhur me ankimet që kanë të bëjnë me **aplikimin e nenit 59 K.Penale ndodh** (Lezhë neni 130a/3 K.Penal) që prokurori i çështjes të bëjë ankim se gjykata nuk ka aplikuar këtë dispozitë Ndonëse nuk përbën shkelje procedurale, çmojmë se kjo vepër mjaft e përhapur kërkon qëndrim korrekt të përfaqësuesit të akuzës në gjyq.
11. Me shqetësim konstatojmë në disa raste, se Gjykata e Apelit Shkodër me të drejtë ka **konstatuar shuarjen e masës së sigurimit** (*humbjes së fuqisë së paraburgimit*) për shkak të kohëzgjatjes së paraburgimit tej afateve procedurale të parashikuara në nënin 261,262 dhe 263 të K.Pr.Penale. Në këto raste nga ana e Prokurorisë së Apelit ju është bërë informacion Drejtuesve të Prokurorisë duke u tërhequr vëmendjen për analizimin e çështjes.
12. Konstatojmë se pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, vinë për gjykim mjaft çështje mbi bazë **ankimi të prokurorit, për pushimin e çështjes, apo dërgimit të çështjes në gjyq**, që gjykatat e faktit, kanë vendosur ndryshe nga kërkesa e prokurorit. Në praktikën e ndjekur nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër, këto çështje gjykohen në dhomë këshillimi **Na shqetëson fakti që e njëta çështje vjen**

- disa here** për gjykim mbi bazën e ankimit të prokurorit të çështjes ku gjykata e ka kthyer për plotësim hetimi dhe ato nuk kryhen sipas përcaktimeve të detyrave të lëna nga ana e saj në vendim.
13. Nga gjykimi i çështjeve ne Gjykatën e Apelit, kemi konstatuar se në disa raste nga ana e prokurorëve **nuk paraqiten konkluzione** me shkrim dhe të administruara në fashikullin e gjykatës së faktit.ndonëse dispozita e K.Pr.Penale neni 378 parashikon *formulojnë dhe parashatrojnë konkluzionet perkatëse...*
14. Ne mjaft raste (në një çështje me disa të pandehur), ka **pafajësi apo dënime më të ulëta se gjysma e kërkuar nga prokurori** dhe nuk ushtrohet ankim nga ana e këtij të fundit...apo duhet theksuar se ka zvarritje të gjykimeve për shkak të **mospjesmarrjes së prokurorit në gjyq**....
15. Pranë Gjykatës së Apelit Shkodër vazhdojnë akoma të gjykohen çështje të vitit 2017, 2018, ku ndër të tjera edhe çështje të vjedhjes së energjise elektrike, mashtrime ne sigurime, etj që për shkak te kohës së gjykimit me vonesë (rreth 4 vite) ju ka humbur dhe aktualiteti, një pjesë e të pandehurve kanë kryer dhe detyrimet ndaj Zyres Vëndore të Shërbimit te Proves, për të cilat jemi vënë në pozitë të përkrahjes së ankimeve të prokurorit.
16. Çmojë se nga ana e prokurorëve, duhet vlerësuar më shumë se deri tani, **çështjet me të arrestuar**, kërkesave në hetimet paraprake, në gjykim dhe pas gjykimit të tyre, duke kushtuar një vëmendje të veçante shkaqeve të paraqitura në ankime dhe njoftimit qoftë dhe në rrugë elektronike Prokurorinë e Apelit Shkodër, më qëllim respektimin e afateve procedurale të paraburgimit. *Shtojmë se gjatë vitit kemi patur probleme lidhur me shuarjen e masave të sigurimit në çështjet më të pandehur të arrestuar (ndonëse çështja është në hetim paraprake)* si mungese informacioni për shkak edhe të faktit se gjykata e apelit Shkodër ka patur mungesa dhe largime të gjyqtarëve nga vetingu dhe çështjet nuk janë vënë në lëvizje në kohën e duhur.
17. **Problematikë mbetet gjykimi i çështjeve me ekstradime**, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe konkretisht: - Ka vonesa në dërgimin e materialeve brënda afateve procedurale të parashikuara ne Kodin e Procedurës Penale. - Në disa raste Ministria e Drejtësisë nuk përgjigjet në kohë kërkesave të prokurorive të rretheve. - Ka zvarritje nga pala Italiane në disa raste çështjet e dërguara nga ana e tyre janë sfumuar duke tërhequr dhe kërkesën për ekstradimë. Në pjesën ma të madhe nga ana e Jonë është kërkuar riçelja e shqyrtimit gjyqësor e tyre për të mundësuar administrimin e akteve nga Ministria e Drejtësisë etj.
Lidhur më këto çështje çmojmë se duhet ndjekur me prioritet dhe në bashkëpunim më të ngushtë Prokurori-Drejtori e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme që për hir të së vërtetës kanë qënë shumë korrekte, me Prokurorinë e Apelit.
18. Problematika kanë dalë nga gjykimi në rastet kur është kërkuar përsëritja e shqyrtimit gjyqësor e **adresave të personit** që tregon rrethana hetimi apo atyre ndaj te cilit zhvillohen hetime (të pandehurve) që kanë vështirësuar njoftimet dhe zvarritjen e gjykimit... çmojmë se prokurorët e çështjeve duhet te insistojnë tek opgj-re, në këtë gjë, duke marrë adresat e plota, nr. e telefonit të kontaktit etj.

Së dyti:

1. Duke qënë se Prokuroria e Apelit vihet në lëvizje mbi bazën e ankimeve të prokurorit dhe palëve të tjera, referuar dhe provojës së deritanishme, çmojmë se:

- duhen rregulluar me një **udhëzim të veçantë** marrëdhëniet mes prokurorisë së shkallës së parë dhe asaj të apelit, dhe anasjelltas,
 - detyrimin e kësaj të fundit në marrëdhënie me komisariatit e policisë, Zyrat Vëndore të Shërbimit të Provës dhe IEVP-të;
 - detyrimet që duhet të kenë palët në lidhje me çështjet e ankimuar,
 - përdorimit më me efikasitet të postës elektronike (*te institucionit*) për të dërguar aktet proceduriale siç janë kërkesat, konkluzionet përfundimtare, ankimet e bëra (shtesa të ankimit), vendimet e gjykatave, problematikave që kanë dalë gjatë gjykimeve, informacionet përkatës etj, të cilat do të rrisin jo vetëm bashkëpunimin institucional edhe efektivitetin e përfaqësimit sa më dinjitoz të përfaqësimit të akuzës në gjyqë.
2. Referuar **Udhëzimit nr.3 datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm** “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, në pikën 2 të “Dispozita të fundit”, thuhet *...Rregullat e parashikuara në këtë udhëzim, zbatohen përse është e mundur edhe në shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokuroritë e Apeleve... çmuj se lidhur* me menazhimin dhe shpërndarjen e çështjeve në Prokurorinë e Apelit, duket riparë për shkak të numrit të paktë të prokurorëve (2), mënyrës se si është e organizuar dhe funksionon Gjykata e Apelit, në gjykim të çështjeve me tre gjyqtarë, të gatishmërisë së prokurorëve etj.

NË VËND TË MBYLLJES

Objektivat dhe prioritetet që kërkohet të arrihen nga ana jonë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten gjykimi i shpejtë, efektiv, në garantim të plotë të të drejtave të pjesëmarrësve gjatë procedimit penal, marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e tjera; zhvillimi i një raporti të ndërsjelltë, më të ngushtë mes prokurorisë; marrëdhëniet me autoritetet e drejtësisë së shteteve të tjera (gjë që natyrisht kërkon një ndihmë nga hallka hierarkike më e lartë); përmirësimi i cilësisë së gjyimit, vendimmarrjes dhe rritjes profesionale të mëtejshme të prokurorëve dhe të stafit të saj. Duke njohur aftësitë edhe mangësitë tona, duke u përpjekur të përmirësohemi në punën tonë, në respektim të kuadrit ligjor, në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese, angazhohemi, për ushtrimin e funksionit tonë në mënyrë që gjykimi të jetë sa më i shpejtë dhe efektiv, duke çuar drejt zgjidhjeve të drejta e ligjore të çështjeve, në respektim të të drejtave të gjithsecilit.

**DREJTUESI I PROKURORISË
LAZER ÇARDAKU**

Shënim: Bashkangjitur evidencat. Të dhënat statistikore janë nxjerrë nga regjistrat që disponon Prokuroria e Apelit Shkodër, dhe në bazë të evidencave që përcillen nga sekretaria, çdo muaj pranë Prokurorisë së Përgjithshme.